U vetëplagos aksidentalisht me pistoletë, i riu në Shkodër merr plumbin në këmbë gjatë ndërrimit të viteve

01 Janar, 2023 14:46

Madhësia e tekstit:

Një shtetas ka mbetur i plagosur në njësinë Postribë në Shkodër pasi ka qëlluar veten aksidentalisht me një pistoletë që mbante pa leje. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 24:00 në momentin e ndërrimit të viteve.

Një shtetas ka mbetur i vetëplagosur në njësinë Postribë në Shkodër. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 24:00 në momentin e ndërrimit të viteve. Një person në moshë të re është vetëqëlluar me armë zjarri në këmbë në mënyrë të pavullnetshme.

Gazetari Senad Nikshiqi ka raportuar për **BalkanWeb** se i riu menjëherë është dërguar në spitalin rajonal të Shkodrës ndërsa ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Mësohet se i riu nga Postribа është vetëplagosur në këmbë por duke mos patur kështu rrezik për jetën.

Pas vetëplagosjes menjëherë në vendngjarje kanë mbërritur forcat e policisë duke nisur punën për hetimin e ngjarjes. Pas hetimeve paraprake policia vendore e Shkodrës ka arritur që të arrestojë personin që u vetëplagos i cili mbante me vete një armë zjarri pa leje. Arrestimi ka ardhur pasi i vetëplagosuri është detyruar që të shkojë në spitalin e Shkodrës për të marrë ndihmë mjekësore.

Shtetasi i vetëplagosur ka qenë në rrugë në momentin kur ka ndodhur ngjarja. Papritur arma e zjarrit pistoletë që mbante me vete është shkrepur duke marrë kështu plumbin në këmbë.

Policia e Shkodrës ka shoqëruar edhe personat e tjerë minoren që e shoqëronin të cilët deklaruan se i riu është vetëplagosur në mënyrë aksidentale. Policia është duke hetuar ngjarjen për të bërë të mundur zbardhjen e plotë të saj për shkaqet që cuan në vetëplagosjen e të riut nga Postribа gjatë natës së ndërrimit të viteve kur të gjithë po festonin.

Njoftimi i policisë:

Shkodër

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Shkodër arrestuan shtetasin S. P., 19 vjeç, për veprën penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municioneve", si dhe nisi procedimit në gjendje të lirë, pas konsultimit me prokurorin, për një shtetas të mitur 15 vjeç, për veprën penale "Plagosja nga pakujdesia".

Nga veprimet hetimore rezultoi se në fshatin Boks të njësisë administrative Postribë, shtetasi S. P., rreth orës 21:00 të datës 31.12.2022, ka shkuar afër një objekti kulti në fshatin Boks, me një armë zjarri pistoletë me vete, për të qëlluar në ajër.

Në këtë vend kanë qenë edhe 15-vjeçari dhe disa shtetas të tjerë të mitur. Shtetasi S. P. i ka dhënë armën e zjarrit 15-vjeçarit, që të qëllonte edhe ai në ajër.

Në momentin që shtetasi S. P. ka dashur t'ia marrë armën 15-vjeçarit, arma është shkrepur aksidentalisht edhe për pasojë është plagosur në këmbë shtetasi S. P.

Shërbimet e Policisë kanë gjetur dhe sekuestruar në vendin e ngjarjes një armë zjarri pistoletë, të cilën e mbante pa leje shtetasi S. P.

Grupi hetimor, nën drejtimin e Prokurorisë, po vijon veprimet për dokumentimin e plotë ligjor të ngjarjes.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për veprime të mëtejshme.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: plagosje

TË NJOHJSHME

Plagosi me thikë 3 persona, si ra në pranga 31-vjeçari në Tiranë
27 Dhjetor, 2022

Plagosi me thikë të rrun, në pranga 19-vjeçari në Korçë(EMRI)
15 Dhjetor, 2022

Taboola Feed

If you own a mouse, you will never turn off your computer again.
Play for free. No Install.
GameBooInger | Sponsored

A Language Learning App That Doesn't Dangle You
Here are 3 reasons why there's nothing holding you back from learning a new language with Babbel.
Babbel | Sponsored
Learn More



Deklarata e fortë e Topalli: Familja ime preç dy muajsh nën vëzhgim
Deklarata e fortë e Topalli: Familja ime preç dy muajsh nën vëzhgim
balkanweb.com

Our tips for reigniting your passion for language learning
Babbel | Sponsored
Learn More

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Lushoja/ Autoboui shpërthen në flakë, shoferi nxjerr menjëherë jashtë pasagjerët
01 Janar, 2023

Ndërroi jetë pas çarrit masiv në gjoksin ku jetonte, kush është adoleshenti shqiptar që jetonte i vetëm prej vitesh në Itali
01 Janar, 2023

Në kërkim për trafik narkotikësh, arrestohet 46-vjeçari në Gramsh(Emri)
01 Janar, 2023

Zjarr i madh në tregun industrial të Durrësit, shkrumbohen pesë dyqane
01 Janar, 2023

Vret veten me armë zjarri 42-vjeçari në Dibër, detajet e para
01 Janar, 2023

Nga dënimi i Tahiri, shuhaja e ministershme e Ervis Martinaj? deri te gjetja e Ilaf Berishës...ngjarjet që 'mbërthyen' vitin 2022
Xhuliana Lala | 31 Dhjetor, 2022

KATEGORIA VIDEO

VIDEO/ Kievi mirëpret Vitin e Ri në errësirë, qytetarët ukrainas brohorasin nga ballkonet
01 Janar, 2023

Tragjedi në Ugandë, 9 të vrarë pas një sfilatjeje me fishekzjarre gjatë festimeve të Vitit të Ri
01 Janar, 2023

Presidenti Begaj bisedë me FA në mision jashtë vendit: Do vijojmë të kontribuojmë në mbrojtë aktive në operacionet të NATO-s
01 Janar, 2023

Kroacia hyn në Eurozonë dhe Shengen, ndryshon monedhën në Euro
01 Janar, 2023

Qindra qytetarë në shesha dhe spektakël fishekzjarresh, ja si u prit ardhja e vitit të ri në qytete të ndryshme të vendit
01 Janar, 2023

Një vajzë dhe një djalë, dy fëmijët e parë të vitit 2023 në Shqipëri
01 Janar, 2023

BalkanWeb

FAQET ZYRTARE
TV News24 Live
News24.al
Radio RASH

PRIVATËSIA
POLITIKA E PRIVATËSISË

KONTAKT
redaksia@balkanweb.com

EMISIONE NEWS24
Alert
Autokinetë
Dola të Ola
Emisioni Vila 24
Fit Station
Frontline
Jeta pa filtër
Kjo Jetë
Klinika 24
Koha për ta ngjarë
Në zemër të Sapur
Në mëngjes me Klarkun
Në shtëpitë
Open
Pikat mbi i
Sport News
Sport News Plus

KATEGORI
Fillimi
Shqipëria
Kosova
Rajoni
Sport
Bota
Kulturë
Metropol
Analiza
Teknologji

MEDIAT E HUAJA
New York Times
Guardian
WEB BBC
WEB CNN
REUTERS
Washington Post
Times Online
Financial Times
WEB Yahoo
WEB MSN
USA Today

© 2023 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.